

Termet e Referencës

Ekspert/Lehtësues për Trajnim

Organizata	HANDIKOS(Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës)
Projekti:	<i>Promovimi i gjithëpërfshirjes në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, nacional dhe regjional</i>
Zbatohet nga:	HANDIKOS
Mbështetur nga:	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
Qëllimi i Angazhimit	Trajnimit për Monitorim, Vlerësim dhe Mësime të Mësuara
Vendi	Prishtinë, Kosovë
Data e publikimit	24 Shtator 2020 (Data e Ri-Publikimit)
Data e pritjes së angazhimit	5 Tetor 2020
Kontakti	handikos@handi-kos.org

1. HYRJE

Në kuadër të Projektit të financuar nga Zyra e BE-së "Promovimi i gjithëpërfshirjes në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, nacional dhe regjional", HANDIKOS ka për synim të ngritë kapacitetin organizativ të OPAK-ve (Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar) dhe rrjeteve të tyre. Në mënyrë që OPAK-et të jenë në gjendje të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën e tyre, ata duhet të ndjekin parimet e qeverisjes demokratike dhe të jenë në gjendje të përfaqësojnë interesat e grupeve të tyre. Intervenimi do t'i mbledhë OPAK-ët, së bashku për të zhvilluar standarde minimale për qeverisje demokratike, përtej asaj që kërkohet nga ligji për regjistrimin e OSHC-ve.

2. OBJEKTIVA E DETYRES

Qëllimi i përgjithshëm i ekspertit do të jetë zhvillimi i përmbajtjes së programit të trajnimit dhe ofrimi i trajnimit për Monitorim, Vlerësim dhe Mësime të Mësuara për programe dhe projekte të OPAK/OJQ, gjatë vitit 2020.

3. FUSHEVEPRIMI

Zhvillimi i programit të trajnimit dhe mbajtja e trajnimit për OPAK:

- Monitorim, Vlerësim dhe Mësime të Mësuara për programe dhe projekte të OPAK/OJQ

Funded by the European Union

Programi i Trajnimit do të drejtohet nga eksperti në koordinim të ngushtë me ekipin e projektit të HANDIKOS dhe partnerët e Projektit.

Eksperti do të jetë përgjegjës për ndërmarrjen e detyrave vijuese:

- Zhvillimi i programit dhe metodologjisë trajnuese 2-ditore për Trajnimin për Monitorimi, Vlerësim dhe Mësime të Mësuara me fokus për programe dhe projekte të OJQ-ve.
- Lehtëson dhe mban trajnimin siç është rënë dakord me ekipin e projektit të HANDIKOS dhe partnerët e projektit.
- Të bashkëpunojë me ekipin e Projektit për të vendosur objektivin, metodologjinë dhe përmbajtjen.
- Të hartoj mjetet për "Monitorim dhe Vlerësim" për t'u shpërndarë pjesëmarrësve
- Përgatit materialet / fletëpalosjet / doracakët e trajnimit për t'u shpërndarë pjesëmarrësve.
- Përgatit raportin e trajnimit.

4. METODAT DHE MJETET

Metodat e mëposhtme mund të përdoren për të përfunduar detyrat e përmendura më lart dhe për të përmbushur qëllimin siç përcaktohet nga kjo TeR.

1. Takime konsultative me HANDIKOS dhe partnerët e Projektit,
2. Trajnim (2 ditë) për Modulin " Monitorimi, Vlerësim dhe Mësime të Mësuara " për përfaqësuesit e OPAK-ve, HANDIKOS dhe Partnerët e Projektit (Ligjërime dhe punë në grupe).
3. Dokumente (punë përgatitore)
4. Prezantimi

5. SHKATHTESITE, PERVOJA DHE KUALIFIKIMET PER EKSPERTIN

Kandidati duhet të posedojë këto aftësi dhe kompetenca:

- Të paktën të jetë i/e diplomuar në fushë të ngjashme
- Përvojë e gjerë pune në monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe projekteve
- Demonstroni përvojë të mëparshme për qasje strategjike për monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe nxjerrjen e praktikave më të mira dhe mësimet të mësuara
- Përvojë në monitorimin dhe vlerësimin e metodologjive përfshirë qasjet kualitative dhe kuantitative të vlerësimit
- Aftësi të mira analitike dhe dokumentacioni / shkrimi të raportit
- Aftësi të mira komunikimi dhe trajnimi
- Komunikimi i shkëlqyeshëm me gojë dhe i shkruar në shqip dhe anglisht
- Ndërgjegjësimi kulturor dhe ndjeshmëria ndaj çështjes së aftësisë së kufizuar

6. KOHEZGJATJA E DETYRES

Kohëzgjatja e detyrës planifikohet të jetë jo më shumë se 2 ditë trajnimi dhe të përfundojë gjatë periudhës Shtator - Nëntor 2020 (bazuar në marrëveshje të ndërsjellë).

7. MATERIALI PER DETYREN

Ekspertë do të punojë ngushtë me ekipin e projektit HANDIKOS. Të gjitha materialet do t'i dorëzohen ekipit të Projektit HANDIKOS në datën siç është rënë dakord reciprokisht gjatë takimit fillestar. Raportet

Funded by the European Union

do të rishikohen nga HANDIKOS dhe partnerët e Projektit. Të gjitha projekt-dokumentet do të dorëzohen në forma elektronike ndërsa produktet përfundimtare do të dorëzohen në formë elektronike dhe kopjet e shtypura.

Eksperti duhet të paraqesë materialet kryesore të mëposhtme:

- Agjenda e trajnimit
- Përmbajtja e programit
- Modeli (shablloni) i mjeteve për Monitorim dhe Vlerësim
- Prezantimi PowerPoint ose llojet e tjera të mjeteve që përdoren për qëllimin e trajnimit
- Doracakë / manuale ose material tjetër për pjesëmarrësit
- Raporti i vlerësimit të trajnimit nga këndvështrimi i ekspertit

8. BUXHETI PER TRAJNIM

Buxheti për trajnimin është planifikuar të jetë 150,00 Euro në ditë (2 ditë * 150,00 Euro = 300,00 Euro).

Projekti do të mbulojë koston financiare për vendin, ushqimin dhe freskimin, materialet dhe logjistikat e tjera të kërkuara të punëtorisë.

Pagesa do të bëhet pas dorëzimit të Raportit të Trajnimit! Departamenti i Financave do të zvogëlojë kontributet tatimore dhe pensionale bazuar në legjislacionin tatimor të Kosovës

9. DATAT TENTATIVE DHE VENDI

Datat tentative: Tetor – Nëntor 2020 (bazuar në marrëveshje reciproke)

Vendi: Do të caktohet në harmoni me masat për COVID 19

10. PROCEDURA PER APLIKIM

Eksperti /kompania e interesuar duhet të paraqesë dokumentet e përmendura më poshtë deri në orën 17:00, të datës 1 Tetor 2020.

- Një CV e përditësuar (Maksimumi 3 faqe)
- Një letër aplikacioni dhe informacione kontakti.
- Koncepti i trajnimit

Ju lutem, indikoni në subjekt “Aplikimi për Trajnimin Monitorimi dhe Vlerësimi”

Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në formën elektronike në adresën: handikos@handi-kos.org

Vetëm kandidatet e listës së ngushtë do të kontaktohen.